

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6355
E hënë, 5 korrik 2021
çmimi 0.40

Kosova e harron demarkacionin me Malin e Zi

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET KONVENTA E DHJETË ZGJEDHORE E PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK) | FAQE 4-5

MEMLI KRASNIQI ZGJEDHET KRYETAR I PDK-së, UROHET EDHE NGA RIVALËT POLITIKË



Memli Krasniqi është zgjedhur kryetar i ri i PDK-së. Pas zgjedhjes në këtë pozitë, ai ka thënë se do ta çojë përpara rrugën e trasuar nga ish-kryetari Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Në këtë kontekst, Krasniqi ka paralajmëruar formimin e një kabineti për qeverisje të mirë, me qëllim të formësimit të vizionit për një

qeverisje të ardhshme. Po ashtu, ai është zotuar se do të bashkëpunojë me secilin anëtar dhe qytetar që dëshiron t'i bashkohet PDK-së. Përpos uratave nga bashkëpartiakët, familjarët dhe miqtë, Krasniqi ka pranuar urime edhe nga rivalët politikë, konkretisht nga Albin Kurti i cili i ka ofruar bashkëpunim

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS KANË SHËNUAR 245-VJETORIN E PAVARËSISË

KOSOVA URON SHBA-në PËR DITËN E PAVARËSISË

Udhëheqësit politikë të Kosovës, 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë së ShBA-së, e kanë vlerësuar shumë të rëndësishme edhe për popullin e Kosovës. Me këtë rast, ata kanë uruar popullin amerikan, duke

thënë se janë të bekuar që ShBA-ja është partnere dhe aleate e pazëvendësueshme e Kosovës. Sipas tyre, qytetarët e Kosovës festën e pavarësisë së ShBA-së e përjetojnë si festë të tyre | FAQE 3



OPINION

BURGU I NISHIT DHE TELEFONATA NGA HASHIM THAÇI, REXHEP SELIMI, KADRI VESELI, "PLAKU" ADEM DEMAÇI F. 10-11

Nga Nait HASANI



AKTUALE

KURTI DO TË INSISTOJË PËR KATËR PROPOZIMET E TIJ EDHE NË TAKIMIN E RADHËS ME VUÇIQUIN F. 7

HARADINAJ NUK BESON SE BE-JA KA AFTËSI TA UDHËHEQË DIALOGUN KOSOVË - SERBI F. 7

MINISTRIA E SHËNDETËSISË: VAKSINAT NGA NORVEGJIA KANË AFAT DHE JANË TË SIGURTA F. 6

EKONOMI

BASHKATDHETARËT KËTË VIT KANË DËRGUAR MË SHUMË PARA NË KOSOVË, PRITEN TË HYRA DERI NË 1 MILIARD EURO F. 9

ZKA-JA IDENTIFIKON MANGËSI NË PROCESIN E FINANÇIMIT TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE F. 9

MINISTRI PEÇI THOTË SE DO TË KOMPENSOHEN FERMERËT E DËMTUAR NGA BRESHËRI F. 9

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhep isht
Tetov⁹
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 010
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin⁹, Kosov⁹,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdojnë hetimet për sulmin kibernetik ndaj një kompanie amerikane

WASHINGTON, 4 KORRIK - Kompania amerikane e teknologjisë informative, që ishte cak i një sulmi të madh kibernetik, po tenton t'i ndihmojë konsumatorët e saj t'i rikthejnë në funksion sistemet e tyre, teksa qeveria amerikane po heton shkallën e këtij sulmi.

Drejtori i kompanisë "Kaseya" ka thënë për mediat amerikane se sulmi ishte i sofistikuar dhe se ekspertët e sigurisë kibernetike besojnë se është kryer nga hakerët rusë.

Grupi i hakerëve, i njohur si "REvil", besohet se ka sulmuar softuerin e kompanisë Kaseya dhe ka afektuar mijëra biznese që marrin shërbime nga kjo kompani.



Kaseya ka thënë se është duke punuar me Byroën Federale të Hetimeve (FBI), duke shtuar se vetëm 40 konsumatorë të saj janë prekur direkt. Por, nga ky sulm mund të preken edhe shumë

kompani të tjera, që varen nga klientët e Kaseyas.

Kaseya mbrëmjen e 3 korrikut ka lëshuar një deklaratë për media, por aty nuk ka treguar se sa konsumatorë janë ndikuar nga

viruset që janë lëshuar nga hakerët.

Kaseya ka thënë se, "fatkeqësisht, kemi qenë viktimë e një sulmi të sofistikuar kibernetik", duke shtuar se beson që sulmi është i kufizuar "në një numër të vogël të konsumatorëve". Kjo kompani ka thënë se të gjithë serverët e prekur duhet të qëndrojnë offline deri në instruksionet e radhës nga ta.

Ndërsa FBI-ja ka thënë se së bashku me Agjencinë për Siguri Kibernetike dhe siguri të Infrastrukturës (CISA) është duke kryer hetime për këtë rast.

Presidenti amerikan Joe Biden ka udhëzuar agjencitë e inteligjencës amerikane që të hetojnë se kush qëndron prapa

këtij sulmi.

Lidhur me sulmet kibernetike, Biden kishte folur me homologun e tij rus, Vladimir Putin, gjatë samitit që patën muajin e kaluar. Bideni ka thënë se më 4 korrik do të dihet më shumë nëse sulmi ndaj Kaseyas ishte "në dijeni apo si pasojë e Rusisë".

Rrjeti më i madh i dyqaneve ushqimore në Suedi, "Coop", ka njoftuar se 800 dyqane janë mbyllur më 3 korrik, pasi një pajisje që përdoret për pagesat u ndikua nga sulmi, që nënkuptonte se kompania nuk mund t'i pranonte pagesat e konsumatorëve. Po ashtu, hekurudhat shtetërore suedeze dhe një farmaci lokale janë prekur nga sulmi.

Bullgaria do të ofrojë stimuj për qytetarët që vaksinohen kundër Covid-19

SOFJE, 4 KORRIK - Bullgaria po e shqyrton mundësinë që të ofrojë stimuj për t'i inkurajuar qytetarët që të vaksinohen kundër koronavirusit, ka thënë të dielën kryeministri i përkohshëm, Stefan Yanev.

Bullgaria është në mesin e pak shteteve që ua ofron mundësinë qytetarëve që të zgjedhin me cilën vaksinë duan të vaksinohen. Aktualisht, në këtë shtet, qytetarët kanë në dispozicion që të zgjedhin në mesin e katër llojeve të vaksinave kundër koronavirusit. Sipas të dhënave, deri më tani 14.5 për qind e popullsisë së rritur në Bullgari është vaksinuar

plotësisht, që e bën një prej shteteve me nivelin më të ulët të vaksinimit në Bashkimin Evropian.

Një prej arsyeve kryesore të mosbesimit në vakcina në Bullgari përmendet frika e qytetarëve ndaj produkteve të reja mjekësore. Një arsye tjetër është se rreth 400 mijë qytetarë tashmë e kanë kaluar virusin dhe kanë fituar imunitet. "Ne nuk planifikojmë që ta detyrojmë askënd (që ta marrë vaksinën), por ne jemi duke e shqyrtuar mundësinë që njerëzit që marrin dozën e dytë, të fitojnë disa kuponë", ka thënë Yanev.

Sofja ka hapur njësi të veçanta të

vaksinimit në parqe, me qëllim që njerëzit të mund të vaksinohen më shpejt dhe, po ashtu, po planifikon fushata vaksinimi në lagjet e banuara nga romët, me qëllim që t'i bindë pjesëtarët e këtij komuniteti për përfitimet nga vaksinat.

Nëse dështojnë që ta përshpejtojnë fushatën e vaksinimit, autoritetet bullgare do të mund të detyrohen që t'i hedhin vaksinat të cilat kanë afat të skadimit.

Yanev tha se Bullgaria mund të përballet me një rrezik të tillë deri në fund të gushtit dhe se po punon me BE-në për t'i parë mundësitë e dhurimit të rreth



150 mijë dozave të vaksinave për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Qeveria e përkohshme bullgare do të qëndrojë në detyrë deri në

formimin e një qeverie të re, pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme të planifikuara për 11 korrik.

Qipro përfshihet nga zjarret, katër persona humbin jetën



NIKOZIA, 4 KORRIK - Katër persona kanë humbur jetën pas zjarreve që kanë përfshirë disa zona të Qipros. Flakët kanë shkatërruar sipërfaqet e pyjeve. Ndikuar edhe nga erërat e forta, zjarri i fuqishëm ka prekur dhjetë komunitete në një sipërfaqe prej 50 kilometrash katrorë në rrëzë të vargmalit Troodos, një

zonë pyjore me pisha dhe shkurre me bimësi të dendura. Viktimat që mendohet të jenë shtetas egjiptianë u gjetën të vdekur afër komunitetit të Odou, një komunitet malor në veri të qyteteve Limassol dhe Larnaca. Qiproja ka bërë thirrje për ndihmë ndërkombëtare për ta shuar zjarrin që, sipas

zyrtarëve, është më i madhi deri më tani. Vendi është duke përjetuar një valë të të nxehtit ekstrem me temperature mbi 40 gradë celsius.

Ekspertët kanë thënë se ndryshimi i klimës pritet ta rrisë frekuencën e ngjarjeve ekstreme të motit. Komisioni Evropian ka deklaruar se disa

avionë nga Greqia dhe Italia janë vendosur në dispozicion për t'i shuar flakët. Disa helikopterë dhe aeroplanë tashmë po trajtojnë flakët, të ndihmuar nga trupat britanike dhe pajisjet e vendosura në ishull. Shkaku i zjarrit, i cili ka filluar rreth mesditës të së shtunës, është ende i paqartë.

31 të vdekur nga rrëzimi i avionit luftarak në Filipine

MANILA, 4 KORRIK - Ushtria në Filipine ka njoftuar se të paktën 31 persona kanë humbur jetën dhe 50 të tjerë kanë shpëtuar pasi një avioni i tipit "C-130" me trupa luftarake në bord është përplasur gjatë uljes në një

provincë jugore të vendit.

Aksidenti i së dielës pranë aeroportit "Jolo" në provincën Sulo ua ka marrë jetën 29 ushtarëve në bordin e avionit dhe dy civilëve.

Zyrtarët kanë thënë se disa

ushtarë ishin parë teksa hidheshin nga avioni para përplasjes dhe shpërthimit në tokë. Ushtria ka theksuar se deri në orët e mbrëmjes 17 ushtarë mbetën të pagjetur. Një komandant ushtarak

rajonar ka deklaruar se nuk kishte gjasa që të ishte qëlluar avioni. Ai ka cituar dëshmitarët të kenë thënë se avioni gaboi në ulje, duke tejkaluar pistën, pastaj u rrëzua në periferi të aeroportit.



SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS KANË SHËNUAR 245-VJETORIN E PAVARËSISË

Kosova uron ShBA-në për Ditën e Pavarësisë

Udhëheqësit politikë të Kosovës, 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë së ShBA-së, e kanë vlerësuar shumë të rëndësishme edhe për popullin e Kosovës. Me këtë rast, ata kanë uruar popullin amerikan, duke thënë se janë të bekuar që ShBA-ja është partnere dhe aleate e pazëvendësueshme e Kosovës. Sipas tyre, qytetarët e Kosovës festën e pavarësisë së ShBA-së e përjetojnë si festë të tyre



bashkohet festës së popullit dhe institucioneve të ShBA-së, partnerë dhe aleatë të pazëvendësueshëm në arritjet tona", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Opozita kërkon të ruhet miqësia e shenjtë me ShBA-në

Me rastin e 4 Korrikut, popullin dhe institucionet amerikane i kanë uruar edhe liderët opozitarë të Kosovës. Në mesazhet e tyre ata kanë kërkuar që të ruhet miqësia e shenjtë me Amerikën.

Kryetari i ri i PDK-së, Memli

Krasniqi, ka vlerësuar se liria dhe pavarësia e Kosovës janë pashmangshme të lidhura me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Lindja dhe ngritja e kombit të madh amerikan i ka dhënë dhe i jep botës gjithmonë siguri e mirëqenie dhe ka mishëruar vlerat më të mëdha njerëzore si liria e demokracia. Liria dhe pavarësia e Kosovës janë pashmangshme të lidhura me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kosova i është mirënjohëse pafundësisht mbështetjes amerikane në rrugëtimin e vet të shtetndërtimit. Ta ruajmë dhe forcojmë këtë miqësi të shenjtë. Gëzuar 4 Korrikun!", ka shkruar Krasniqi në profilin e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i LDK-së, Lumit Abdixhiku, ka deklaruar se për Kosovën, ShBA-ja ishte dhe është aleatja jetike në ekzistencën tonë si komb dhe si shtet. "Sot ShBA-ja feston Ditën e Pavarësisë, një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme në përpjekjen e popullit amerikan drejt arritjes së synimeve dhe idealeve për liri dhe pavarësi. Që nga ai moment Shtetet e Bashkuara në politikën botërore mbajnë flamurin e lirisë dhe të demokracisë. Për Kosovën, ShBA-ja ishte dhe është aleatja jetike në ekzistencën tonë si komb dhe si shtet. Në momentet më

kruciale, kur populli ynë po ballafaqohej me jetë o vdekje, Shtetet e Bashkuara vepruan në mbrojtjen e idealit për liri dhe çlirim, ideal dhe synim që e ka të brumosur në vetë gjenezën e vetë si shtet nga etërit themelues", ka vlerësuar ai.

ShBA-në e ka uruar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Urimet më të përzemërta për popullin dhe shtetin amerikan, me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara. 4 Korriku përçon mesazhin e idealeve të larta dhe vlerave universale të demokracisë. 4 Korriku është vetë mesazhi i lirisë së kombeve. Kosova do të jetë gjithmonë përkrah Amerikës, e cila është shembull që ne me krenari e ndjekim. 4 Korriku është edhe festë e jona. Urime!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se shembulli më i mirë për t'u ndjekur nga shtetet dhe kombet, janë pikërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Qytetarët tanë i janë përjetë mirënjohës SHBA-së për kontributin dhe ndihmën e dhënë për Kosovën në të gjithë etapat. Kosova është e bekuar që ka miqësi me ShBA-në dhe miqësia me të do të jetë e përjetshme", ka shkruar Limaj.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 KORRIK - Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë uruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës me rastin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë. Ata kanë vlerësuar se ShBA-ja ka qenë dhe është aleatja më jetike e Kosovës. Ata kanë vlerësuar se ky shtet i doli në krah popullit të Kosovës atëherë kur kishte më së shumti nevojë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë Dita e Pavarësisë e ShBA-së kujton rolin e këtij shteti për jetësimin e synimit të Kosovës për pavarësi. "Sot populli amerikan feston 245-vjetorin e pavarësisë, kurse ne miqtë e tyre bashkëfestojmë me ta, ngaqë kjo ditë na e kujton rolin e këtij kombi të madh për jetësimin e synimit tonë për të jetuar të lirë e të mosvarmë. Historia ka dëshmuar se në çastet më të vështira për kombin tonë, Amerika zgjodhi të ishte mbrojtësja dhe promovuesja më e madhe e së drejtës sonë, duke u rreshtuar përkrah nesh në përpjekjet tona për liri", ka shkruar Osmani në profilin e vet në "Facebook". Sipas saj, qytetarët e Kosovës festën e pavarësisë së ShBA-së e përjetojnë si festë të tyre. "Prandaj, ne shqiptarët, populli mik i kombit amerikan, sot ndihemi të bekuar me miqësinë me të. Kjo miqësi mbështetet sa në përkushtimin tonë ndaj lirisë, po aq edhe në vlerat e përbashkëta të cilat ne i ndajmë me kombin amerikan. Qytetarët e Kosovës sot e përjetojnë festën e pavarësisë së

ShBA-së si festë të tyre. Ata luten për mirëqenien e popullit amerikan dhe urojnë njëri-tjetrit për miqësinë me të, e cila, sikur thoshte presidenti historik i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, "është e përhershme", ka shkruar ajo.

Edhe kryeparlamentari Glauk Konjufca ka uruar ShBA-në për këtë ditë, duke shkruar në profilin e vet në "Facebook": "Gëzuar 4 Korrikun, Amerikë!".

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ShBA-ja është partnere dhe aleate e pazëvendësueshme në arritjet e Kosovës. "Idetë dhe idealet më fisnike, besimi në liri, barazi dhe të drejta individuale, përfshirë të drejtën e çdo personi për të kërkuar lumturinë - që burojnë nga Deklarata e Pavarësisë e ShBA-së, vazhdojnë të frymëzojnë popuj e individë anembanë botës. Në këtë Ditë të Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shteti i Kosovës i

Në të gjitha kazermat e FSK-së ngrihet flamuri amerikan

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Armend Mehaj, ka bërë me dije se me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka marrë vendim që në të gjitha kazermat e FSK-së të ngrahet flamuri amerikan. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se këtë vendim e ka marrë për t'i nderuar të gjithë burrat e gratë e kombit amerikan. "Vlerat amerikane janë pjesë e identitetit tonë shtetëror dhe qytetarë, sepse e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë qëndrojnë të palëkundura në themelet e lirisë, barazisë dhe drejtësisë së 4 Korrikut. Si ministër i Mbrojtjes dhe si qytetar i Republikës së Kosovës, uroj nga zemra të gjithë burrat e gratë e vendit mik, ShBA-së, me të cilët bashkë, si një trup i vetëm, po rrugëtojmë në zhvillimin dhe forcimin e Republikës së Kosovës", ka shkruar Mehaj.

Gjenerali Wesley Clark të mërkurën viziton Kosovën

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Gjenerali amerikan, i cili kishte udhëhequr kampanjën e bombardimeve të NATO-s në luftën e Kosovës, Wesley Clark, do ta vizitojë të mërkurën vendin tonë. Lajmin e ka dhënë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, teksa ka uruar për Ditën e Pavarësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). "Në këtë ditë të veçantë, kur po festojmë 4 Korrikun - Ditën e

Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kam kënaqësinë t'ju njoftoj se me ftesën time zyrtare, më 7 korrik, në Ministrinë e Mbrojtjes, do të vijë në vizitë gjenerali historik amerikan, heroi ynë Wesley Clark", ka njoftuar Mehaj. Mehaj ka thënë se Clarku do të pritë me nivelin më të lartë ceremonial ushtarak dhe do t'i takojë të gjithë liderët shtetërorë. "Gjeneral Clark do të pritë me nivelin

më të lartë ceremonial ushtarak dhe atë të protokollit shtetëror dhe do të pritë nga të gjithë liderët tanë më të lartë shtetërorë", ka thënë Mehaj.

"Mirë se vjen në shtëpinë tuaj, pranë njerëzve që të duan shumë, gjeneral Clark! Mirë se vjen në Kosovën dhe qytetarët e saj të bekuar me ty dhe ShBA-në! Zoti e bekoftë përjetësisht miqësinë e Kosovës me ShBA-në!", është shprehur Mehaj.





MBAHET KONVENTA E DHJETË ZGJEDHORE E PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK)

Memli Krasniqi zgjedhet kryetar i PDK-së, urohët edhe nga rivalët politikë

Memli Krasniqi është zgjedhur kryetar i ri i PDK-së. Pas zgjedhjes në këtë pozitë, ai ka thënë se do ta çojë përpara rrugën e trasuar nga ish-kryetari Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Në këtë kontekst, Krasniqi ka paralajmëruar formimin e një kabineti për qeverisje të mirë, me qëllim të formësimit të vizionit për një qeverisje të ardhshme. Po ashtu, ai është zotuar se do të bashkëpunojë me secilin anëtar dhe qytetar që dëshiron t'i bashkohet PDK-së. Përpos uratave nga bashkëpartiakët, familjarët dhe miqtë, Krasniqi ka pranuar urime edhe nga rivalët politikë, konkretisht nga Albin Kurti i cili i ka ofruar bashkëpunim



vitet 2020, kur Kadri Veseli dha dorëheqje nga drejtimi i partisë pasi Dhomat e Specializuara të Kosovës ia konfirmuan aktakuzën për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Që nga ajo kohë Veseli është në paraburgim në Hagë. PDK-ja për gati 17 vjet u udhëhoq nga ish-kryetari Hashim Thaçi, i cili, po ashtu, është në paraburgim në Hagë pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Krasniqi urohët nga Kurti dhe Mustafa

Zgjedhja e Memli Krasniqit në krye të PDK-së është përshëndetur edhe nga rivalët e tij politikë. Kryeministri i Kosovës dhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka uruar Krasniqin për pozitën e re, duke i ofruar edhe bashkëpunim. "I uroj punë të mbarë kryetarit të ri të PDK-së, z. Memli Krasniqi. Mbështetja që mori sot nga strukturat e subjektit të tij i garanton një udhëheqje stabile për t'i zhvilluar reformat që mendon se janë të nevojshme për PDK-në. Si kryeministër i Kosovës dhe kryetar i Lëvizjes i ofroj bashkëpunim në temat me interes nacional dhe ballafaqim të ideve e qëndrimeve për të mirën e përbashkët të shtetit dhe qytetarëve. Të punosh për Kosovën e kombin tonë nuk është kurrë mjaftueshëm dhe e kemi obligim secili", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe ish-kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka uruar Memli Krasniqin për zgjedhjen kryetar të PDK-së, derisa ka vlerësuar punën e tij gjatë kohës kur ishte ministër në qeverinë e tij. "Uroj zotin Krasniqi zgjedhjen kryetar i PDK-së. Është çështje e interesit të kësaj partie për t'u ballafaquar me sfidat e brendshme sikurse edhe me opozitarizmin", ka thënë Mustafa. Memli Krasniqi është uruar edhe nga djali i Hashim Thaçit, Endriti dhe djali i Kadri Veselit, Klestori.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 KORRIK - Memli Krasniqi është zgjedhur të shtunën kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Krasniqi është zgjedhur në këtë pozitë me shumicë votash të delegatëve pjesëmarrës në konventën zgjedhore të partisë. Në votim kanë marrë pjesë 476 delegatë. Vetëm shtatë ishin kundër. Në deklarinë e tij të parë pas marrjes së pozitës së kryetarit, Krasniqi ka thënë se do ta çojë përpara rrugën e trasuar nga ish-kryetari Hashim Thaçi e Kadri Veseli në krye të PDK-së. Krasniqi ka thënë se do të bashkëpunojë me secilin anëtar dhe qytetar që dëshiron t'i bashkohet PDK-së. "Gjatë rrugës për rikthimin e PDK-së aty ku e ka vendin në udhëheqjen e shtetit, padyshim se do të kemi shumë sfida. Padyshim se do të kemi shumë pengesa dhe jam absolutisht i sigurt se nuk do të jetë fare e lehtë, por unë e njoh shpirtin e partisë sonë të përbashkët. E njoh vullnetin që buron nga secili prej jush këtu dhe buron nga ata dhjetëra mijëra anëtarë të partisë sonë. Duke u bazuar në këtë energji të

pashtershme, unë jam i sigurt se bashkë do t'ia dalim", ka thënë Krasniqi. Në konventë Krasniqi ka paraqitur platformën që synon ta zbatojë gjatë mandatit të tij. Në paraqitjen e platformës, Krasniqi ka thënë se synon që PDK-në ta kthejë në vendin e parë dhe që të qeverisë vendin. "Ne sot jemi në opozitë. Kanë qenë edhe gabimet tona që i kanë kontribuar kësaj situatë. Ndoshta s'kemi mundur ta lexojmë saktë disponimin e votuesve, prandaj edhe në dy palë zgjedhjet e fundit nuk kemi marrë mjaftueshëm mbështetjen e tyre. Reflektimi është i domosdoshëm. Nuk mund të vazhdojmë më tutje njëjtë. Në këtë pikë besoj se

pajtohemi të gjithë. Kështu si jemi sot, nuk mjafton për t'u rikthyer. Por, ne qëllimin e kemi për t'u rikthyer", ka thënë Krasniqi. Më tutje, Krasniqi ka thënë se beteja kryesore e PDK-së është në Kuvendin e Kosovës, duke i ftuar deputetët e këtij subjekti politik që të angazhohen sa më shumë në punën e tyre në këtë institucion. Ai ka thënë se do të formojë një kryesi të re me të rinj dhe të reja si dhe me njerëz që janë rritur në Partinë Demokratike të Kosovës. Mes të tjerash, Krasniqi ka paralajmëruar formimin e një kabineti për qeverisje të mirë, me qëllim të formësimit të vizionit për një qeverisje të ardhshme. Krasniqi ka thënë se PDK-ja duhet

ta kthejë mbështetjen e rinisë. Memli Krasniqi ishte kandidati i vetëm në këtë garë pasi asnjë anëtar tjetër i PDK-së nuk paraqiti kandidaturën për kryetar të këtij subjekti politik. Në garë për kryetar të PDK-së pritej që të ishte edhe Enver Hoxhaj, i cili për tetë muaj ishte ushtrues i detyrës i kryetarit të këtij subjekti politik, mirëpo pak kohë para përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturave Hoxhaj njoftoi se nuk do t'i hyjë garës për kryetar. Në hapje të konventës, Hoxhaj ka thënë se shumëkush ka pritur që ai do të garonte për të parin e PDK-së por, sipas tij, PDK-ja ka nevojë për një reformim dhe udhëheqësi të re. "Nga kjo konventë presim që ta forcojmë edhe më shumë identitetin tonë si parti shtetformuese, por edhe si parti e djathtë. Të dalim me qëndrime të qarta dhe të shpejta për të mbrojtur demokracinë, lirinë, ekonominë e tregut dhe lirinë e shprehjes", ka thënë Hoxhaj. Ai ka shtuar se kjo konventë e partisë po zhvillohej në rrethana jonormale pasi për herë të parë në të mungojnë ish-kryetari Kadri Veseli dhe ish-presidenti Hashim Thaçi. Partia Demokratike e Kosovës mbeti pa kryetar më 5 nëntor të



PDK-ja MIRATON DEKLARATË POLITIKE 23-PIKËSHE

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pas zgjedhjes Memli Krasniqit në krye të kësaj partie, ka miratuar edhe një deklaratë politike, e cila përmban 23 pika. Përmes kësaj deklarate PDK-ja ka shprehur krenarinë për origjinën e saj politike që buron nga kauza për çlirimin e vendit dhe lufta e drejtë dhe e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (PDK).

Deklarata politike e PDK-së:

1. Partia Demokratike e Kosovës është krenare për origjinën e saj politike që buron nga kauza për çlirimin e vendit dhe lufta e drejtë dhe e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Partia Demokratike e Kosovës është e vendosur për të promovuar dhe mbrojtur vlerat sublimë të kauzës kombëtare për liri dhe pavarësi, që janë manifestuar në rrugëtimin historik të Kosovës dhe popullit të saj.
3. Partia Demokratike e Kosovës, beson në drejtësi të paanshme dhe është e përkushtuar për të respektuar në plotni të gjitha instancat e drejtësisë që synojnë të vënë në pah të vërtetën e luftës së drejtë dhe të pastër të UÇK-së.
4. Në kuadër të këtij përkushtimi, PDK-ja, megjithëse e lënduar politikisht nga aktakuza ndaj Kryetarit Kadri Veseli, akt që ka goditur organizimin politik, e mirëpret një proces të pavarur, të pandikuar dhe të drejtë për lirimin sa më të shpejtë nga pretendimet e pabaza!
5. Në rrethanat e tilla të krijuara dhe të imponuara, PDK-ja është e vendosur që të rimëkëmbet dhe të vazhdojë rrugëtimin e saj drejt rikthimit të plotë politik dhe identitar.
6. PDK-ja është e vendosur që të vazhdojë rrugën e reformës në rrafshin strukturor, në rrafshin politik dhe në rrafshin ideacional, në mënyrë që të rikthehet sa më parë si forcë kryesore drejtuese politike në krye të institucioneve të Republikës së Kosovës.
7. Mbi këtë qëllim, PDK-ja me lidhshmëri e ri, do të reformohet për të avancuar agjendën politike në drejtim të ballafaqimit me pushtetin e papërgjegjshëm dhe keqeverisjen aktuale dhe në drejtim të mobilizimit politik që së bashku me qytetarët, të kufizojë qeverisjen e dëmshme dhe ta rikthejë qeverisjen e zhvillimit, emancipimit, dinjitetit dhe integritetit.

8. Për të përmbushur këtë nevojë të domosdoshme, Konventa zgjedhore e PDK-së, ka për qëllim të nxjerrë formatin e ri të lidhshmërisë, të prodhojë qasjen e re konceptuale dhe të përcaktojë ritmin e ri të angazhimit deri në rikthimin e plotë e të pa lënduar të mbështetjes qytetare.

9. PDK-ja ka traditë, është e përkushtuar, aspirojnë dhe rrugëton në konsolidimin e strukturave të veta përmes procesit të lirë zgjedhor, demokratik dhe të bazuar mbi parime dhe norma.

10. Partia Demokratike e Kosovës respekton zgjedhjen e lirë, të drejtën e kandidimit dhe konkurrencën politike për lidhshmëri e saj, si dhe është e përkushtuar për të respektuar rezultatet e procesit legjitim zgjedhor që del nga rregullat e përcaktuara për zgjedhjet e brendshme për strukturat e partisë.

11. Partia Demokratike e Kosovës i kushton rendësi ndryshimit strukturor përmes kultivimit të një kulture të përgjegjshme politike, e cila e një procesin legjitim të transformimit në strukturat e saj, dhe e cila kultivon respektin për drejtuesit dhe strukturat e saj pas përfundimit të mandatit të tyre drejtues.

12. Partia Demokratike e Kosovës është shtëpi e hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë vullnet, kompetencë dhe përkushtim, për

Ali Ahmeti uron Memli Krasniqin: Të inkurajoj ta vazhdojë rrugën e Thaçit dhe Veselit

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritet (BDI), Ali Ahmeti, ka uruar Memli Krasniqin me rastin e zgjedhjes kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Me këtë rast, Ahmeti ka inkurajuar Krasniqin që ta vazhdojë rrugën e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. "I dashur Memli, përzemërsisht të uroj për marrjen e përgjegjësisë dhe zgjedhjen kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës në një proces demokratik dhe transparent. Nevojitet guxim i

veçantë për të marrë mbi supë përgjegjësi në kohë sfiduese dhe për këtë të inkurajoj që ta vijosh rrugën e trasuar nga paraardhësit e tu të cilët na mungojnë shumë dhe uroj si dhe kam bindjen që do të rikthehen shpejt, faqebardhë dhe krenarë. Dy partitë tona ndajnë vlera të përbashkëta për demokracinë, lirinë, sundimin e ligjit, shtetësinë e Kosovës dhe integritimin e dy vendeve në Bashkimin Evropian dhe në NATO", ka shkruar Ahmeti në

llogarinë e vet në "Facebook". Më tutje, Ahmeti ka thënë se BDI-ja do ta ketë PDK-në partnere të sinqertë. "Tek unë dhe te BDI do të gesh partnerë të sinqertë dhe të përkushtuar për punë të mbara sepse Kosova, thellë në mendjet dhe zemrat tona, është mall, është realizim ëndrrash, është zenit jetësor. Të uroj shëndet dhe mbarësi në sfidën e re me dëshirat më të sinqerta për sukses në të mirën e përbashkët të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe rajonit", ka shkruar Ahmeti.

t'i dhënë Kosovës, shoqërisë dhe institucioneve publike, një format të ri të vlerave politike civile, si dhe angazhim dhe veprim politik në funksion të ngritjes së Republikës së Kosovës në rangun e shteteve të zhvilluara dhe me të ardhme prosperuese.

13. Partia Demokratike e Kosovës, është adresë politike unike, e bashkuar, e hapur për të gjithë burrat dhe gratë, për të rinjtë dhe të rejtat, për profesionistë dhe aktivistë që aspirojnë një rrugëtim të ri politik dhe një tregim të ri për të ardhmen që i duhet vendit tonë.

14. Partia Demokratike e Kosovës

do të angazhohet për t'iu ofruar qytetarëve një projekt të ri politik qytetar, në qendër të së cilit graviton zhvillimi ekonomik, barazia e shanceve si kusht themelor, sundimi efikas i rendit dhe ligjit, lufta kundër privilegjit, integriteti i institucioneve, zhvillimi i agjendës njerëzore dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, konsolidimi dhe zbatimi i kushtetutshmërisë së Republikës, mirëqenia e qëndrueshme e individëve, familjeve, komunitetit dhe shoqërisë, si dhe për sigurinë dhe të ardhmen e brezave të rinj të saj.

15. Partia Demokratike e Kosovës është e vendosur që rrugëtimin e mëtejshëm politik të rimëkëmbjes, ta realizojë së bashku me qytetarin e Kosovës, duke e marrë në referencë përditshmërinë e tij, aspiratat dhe mundësitë që i duhen për të gjetur materializim individual në çdo dimension të jetës së tij.

16. Partia Demokratike e Kosovës, prirë nga toleranca politike dhe është e hapur për bashkëpunim pavarësisht relacionit që ka me pushtetin në kohë dhe kontekste të caktuara, me qëllim që të japë kontribut për zhvillimin e mëtejshëm të sferës publike, për zhvillimin ekonomik të vendit në bazë të parimeve të tregut të lirë, për avancimin e agjendës njerëzore dhe qytetare në Republikën e Kosovës.

17. Partia Demokratike e Kosovës angazhohet fuqimisht për të vendosur një lidhje më të qëndrueshme në mes qendrave dhe periferive, me qëllim që asnjë qytetar, familje, vendbanim, rajon apo komunë, të mos lihet në disavantazh nga mundësitë zhvillimore që krijon shoqëria jonë.

18. Partia Demokratike e Kosovës është e përkushtuar që në zgjedhjet lokale para nesh, t'iu

ofrojë qytetarëve, bizneseve dhe komuniteteve, zgjidhjet më të mira për të cilat ata kanë nevojë, profilet më të denja për qeverisje dhe një zotim të hapur për çlirimin e potencialit zhvillimor në çdo komunë të Republikës së Kosovës.

19. Partia Demokratike e Kosovës është e përcaktuar për aleancë të përhershme me partnerët strategjik dhe është e përkushtuar për të zgjeruar bashkëpunimin në kuadër të këtij partneriteti, me theks të veçantë me ShBA-të, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, me qëllim të realizimit të synimeve të përbashkëta në të mirë të vendit, rajonit dhe rritjes së paqes dhe sigurisë globale.

20. Partia Demokratike e Kosovës angazhohet për një lidhje të fortë socio-ekonomike, kulturore dhe edukative me diasporën tonë.

21. Partia Demokratike e Kosovës inkurajon, fton dhe është e hapur për të gjithë qytetarët që kanë moshën e përcaktuar me ligj, për t'iu bashkëpunim rrugës së re dhe projektit të ri politik që i adresohet të rinjve dhe të rejave duke njohur rolin e tyre vital e të pazëvendësueshëm në projektimin dhe ndërtimin e të ardhmes së Kosovës që e duam të gjithë.

22. Partia Demokratike e Kosovës, është mirënjohëse dhe shprehë konsideratë të lartë për angazhimin dhe punën e të gjitha organeve, strukturave dhe mbështetësve të saj, për trashëgiminë e përbashkët politike mbi atë çfarë i kemi dhënë Kosovës deri më sot, si dhe rrugën e re që do ta ndërtojmë së bashku.

23. Partia Demokratike e Kosovës, është e bashkuar, e fortë, unike, e aftë dhe e gatshme që së bashku me qytetarët, ta materializojë vizionin e saj për Kosovën dhe të ardhmen prosperuese të shoqërisë tonë.

Memli Krasniqi bën homazhe në kompleksin memorial "Adem Jashari"

Kryetari i ri i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në ditën e parë të punës në këtë cilësi, së bashku me familjen ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Me këtë rast, ai ka thënë se vizita në këtë vend është e domosdoshme para marrjes së përgjegjësisë të reja. "Prekazi mbetet udhërrëfyesi ynë sepse ky është vendi ku ka lindur dhe ku ka marrë kuptim liria e Kosovës. Andaj e konsideroj të patejkalueshme dhe të domosdoshme ardhjen në Prekaz para marrjes së çfarëdo përgjegjësie. Pra, është edhe nder, obligim, privilegj dhe përgjegjësi që në ditën e parë si kryetar i PDK-së, së bashku me familjen time të vij në Prekaz për të marr një frymëzim shtesë dhe për ta fuqizuar vetëdijen tonë politike për punët të cilat na presin dhe për të marrë një inspirim shtesë nga sakrificat titanike e familjes Jashari", ka deklaruar Krasniqi.



Milazim Krasniqi, fjalë emocionuese për Memlin që u zgjodh kryetar i PDK-së

Profesori universitar Milazim Krasniqi përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka uruar me fjalë emocionuese birin e tij, Memli Krasniqi, pasi ky i fundit është zgjedhur kryetar i PDK-së. Krasniqi ka thënë se për familjen e tij, kjo arritje e Memlit është përmbushje e besimit që kanë

pasur në të. Më tutje, Krasniqi ka thënë se PDK-ja është pjesë substanciale e lirisë dhe ndërtimit të shtetit e, sipas tij, ta udhëheqësh PDK-në i bie ta prekësh me dorë historinë e këtij shteti. "Zgjedhja e Memlit kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, për mua, Edibën dhe gjithë familjen tonë, është një

përmbushje e besimit që gjithnjë kemi pasur dhe e kemi në Memlin, si një djalë i mbarë, i suksesshëm, i dashur, i përkushtuar, me vlera të larta njerëzore. Memli e ka pasur dhe e ka gjithmonë përkrahjen tonë të plotë, në të gjitha projektet, sepse ne e dimë që ai angazhohet vetëm në punë të

mira, të mbara e të dobishme, për familjen e për vendin tonë të dashur. Prandaj e ka përkrahjen tonë të plotë edhe në detyrën e tij të re dhe me shumë përgjegjësi. Të udhëheqësh PDK-në, realisht është ta prekësh me dorë historinë e këtij shteti, sepse PDK-ja është pjesë

substanciale e lirisë dhe e ndërtimit të shtetit tonë. Ne besojmë se historia e lavdishme e këtij projekti politik dhe oferta e re për kohën që kemi përpara, do t'i prijë Memlit tonë drejt sukseseve të reja. Urime, babush! Zoti të ndihmoftë!", ka shkruar Krasniqi.

A duhet të bëhet e obligueshëm marrja e vaksinës kundër Covidit?

PRISHTINË, 4 KORRIK - Derisa në Kosovë është duke vazhduar vaksinimi masiv kundër Covid-19, sipas një testi publik, rreth 56 për qind e popullatës është duke refuzuar ta marrë këtë vaksinë, ka bërë me dije deputeti nga radhët e AAK-së dhe infektologu Shemsedin Dreshaj. Ai ka thënë se injektimi kundër Covid-19 duhet të bëhet obligues, derisa për ata që refuzojnë ta bëjnë një gjë të tillë dënimet mund të parashihen me ligj.

Dreshaj ka pohuar se menaxhimi i pandemisë nuk nënkupton vetëm vaksinim pasi në Kosovë, sipas tij, ende nuk ka ndodhur as vaksinimi masiv. "Deri më sot vaksinimi kundër Covidit nuk është obligues askund në botë, por në një situatë dhe në një test publik të bërë me popullatën në Kosovë, ka dalë që rreth 56 për qind e personelit hezitojnë ta marrin vaksinën. Atë se çfarë unë propozoj është se kjo vaksinë të bëhet obliguese sepse ne kemi drejt ta rrezikojmë veten, por ne nuk kemi të drejtë t'i rrezikojmë të tjerët që nuk kanë ardhur deri te vaksinimi. Unë mendoj se kjo mund të realizohet dhe që është prezantuar si refuzuese, për shkak se ne pretendojmë që mbi 60 për qind e popullatës të vaksinohet sipas planit të qeverisë. Atëherë është brengosëse një situatë e tillë dhe kjo nënkupton domosdoshmërinë për



marrjen e hapave konkretë të promovimit të vaksinës dhe promovimit të efektit mbrojtës

së vaksinës", ka deklaruar ai, duke shtuar se çështja e vaksinimit duhet të

përcaktohet me ligj.

Ndërsa ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, ka

thënë se nuk e sheh të arsyeshme që vaksinimi kundër Covid-19 të jetë i obligueshëm. "E kemi situatën me sëmundjet e tjera paraprake që kanë qenë. Kemi edhe situatën me gripin sezonal që ka qenë para disa dekadave vdekjeprurës, por asnjëherë nuk kemi ardhur deri në stadin që të nxirret ligj me të cilin do të vaksinohet çdo qytetar. Që qytetarët të jenë të obliguar të vaksinohen është çështje e të drejtave të njeriut dhe ata të vendosin vetë se a do ta marrin vaksinën apo jo", ka deklaruar Agani për "EO". Ndërsa kryetari i Odës së Mjekëve, Pleurat Sejdiu, ka thënë se duhet të mbizotërojë e drejta individuale e secilit qytetar për t'u vaksinuar, përkundër faktit që mosmarrja e vaksinës mund t'i rrezikojë të tjerët.

Një i vdekur dhe nëntë raste të reja me Covid

Prishtinë, 4 korrik (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka vdekur një person dhe janë paraqitur nëntë raste të reja me Covid-19. "Nga 1 871 testime, 9 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i të vdekurit. Sot janë shëruar 14 qytetarë, derisa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 105 376. Në total numri i rasteve aktive është 160", ka njoftuar MSh-ja.

Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë vaksinuar kundër Covidit mbi 1 100 persona. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 1 110 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës



janë dhënë 205 884 doza të vaksinës. Deri më sot 49 207 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", ka njoftuar MSh-ja.

Ministria e Shëndetësisë: Vaksinat nga Norvegjia kanë afat dhe janë të sigurta

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka demantuar deputetin e PDK-së, Bekim Haxhiu, i cili ka thënë të shtunën se dikush nga qeveria duhet të përgjigjet për donacionin e vaksinave të ardhura nga Norvegjia. Ai ka kërkuar të dijë se sa prej këtyre vaksinave u ka skaduar afati i përdorimit më 30 qershor dhe sa prej tyre u skadon më 30 korrik.

Kjo ministri ka bërë me dije se të gjitha vaksinat kundër Covid-19 edhe ato që kanë ardhur nga Norvegjia kanë afat të mjaftueshëm për përdorim dhe i kanë kaluar të gjitha procedurat e aprovimit për përdorim të sigurt. "Ministria e Shëndetësisë i siguron qytetarët e Republikës së Kosovës, se të gjitha vaksinat kundër Covid-19, të cilat janë duke u dhënë në Kosovë, përfshirë edhe ato që janë marrë këtë javë donacion nga Mbretëria e Norvegjisë, kanë afat të mjaftueshëm përdorimi dhe i kanë kaluar të gjitha

procedurat e aprovimit për përdorim të sigurt. Dezinformatat lidhur me afatin e përdorimit për vaksinat e pranuar nga Mbretëria e Norvegjisë, të bëra nga individë të ndryshëm, përveç që shkaktojnë pasiguri te qytetarët në këtë kohë kur vaksinimi kundër Covid-19 ka fituar një dinamikë intensive, flasin edhe për mungesën e respektit ndaj donatorit - shtetit të Norvegjisë", është thënë në reagimin e MSh-së. MSh-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që edhe më tej të aplikojnë për vaksinim. "Duke u bërë thirrje qytetarëve që të aplikojnë përmes platformës e-Kosova (<https://ekosova.rks-gov.net/>) për marrje të vaksinës kundër Covid-19, MSh-ja rikujton faktin se Kosova është nga shtetet e rralla në rajon që nuk ka pranuar të marrë vakcina të paaprovuara nga EMA-ja dhe OBSH-ja për përdorim kundër Covid-19", është thënë në këtë reagim.



Kurti do të insistojë për katër propozimet e tij edhe në takimin e radhës me Vuçiqin

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do të insistojë për katër propozimet e tij të cilat i ka paraqitur në takim me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Mirëpo, të njëjtat pika janë duke u vlerësuar jorealiste nga shoqëria civile për të ecur përpara në procesin e dialogut Kosovë - Serbi.

Përkundër që s'ka pajtueshmëri për agjendën e diskutimit më 25 korrik, është raportuar për një takim të rangut më të ulët në ditët e ardhshme, por që i njëjti nuk është konfirmuar as nga Qeveria e Kosovës, as nga Bashkimi Evropian.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka thënë se presin që katër propozimet e dhëna në takimin e parë Serbia t'i marrë seriozisht dhe të vazhdohet tutje. "Ne kemi katër propozimet që i kemi në takimin e fundit. Presim që

ato propozime t'i marrë seriozisht Serbia dhe të vazhdojmë tutje. Këto janë katër propozimet tona të cilat ne do të insistojmë që Serbia t'i pranojë. Nuk e di për këtë, nuk kam informata. Për këtë duhet ta pyesni qeverinë", ka deklaruar ajo për "Ksp".

Këtë qasje nuk është duke e parë të favorshme për Kosovën Emir Abrashi nga Demokracia Plus, i cili ka thënë se katër propozimet e kryeministrit Kurti janë të mira, por jorealiste për të ecur përpara në kuadër të dialogut. "Katër propozimet e kryeministrit Kurti janë të mira, por janë jorealiste për të vazhduar përpara. Për shkak se ne nuk do të marrim një zotim nga pala serbe, në mungesë të këtij zotimi, i cili do të jetë qëndrimi i Kosovës: A do të vazhdojmë procesin e dialogut apo do të tërhiqemi? Vetë fakti i dialogut nënkupton se ne duhet të arrijmë në një pikë

kompromisi. Prandaj mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të punojë ngushtë me partnerët tanë për t'i shtyrë përpara gjërat që neve na konvenojnë. Megjithatë, nuk mund të jemi kryeneçë në këtë proces dhe nuk mund të jemi palë jokonstruktive në procesin e dialogut", ka thënë ai.

Lidhur me nevojën e takimeve të një rangut më të ulët politik për t'u pajtuar rreth agjendës, Abrashi ka thënë se takimet e tilla koordinuese janë të mira, por pajtimet mund të bëhen edhe në koordinim me ndërmjetësuesit e dialogut, në këtë rast Bashkimin Evropian. "Secili takim koordinues është i mirë sepse ne arrijmë të kemi një qartësi sa i përket vazhdimësisë së procesit të dialogut. Megjithatë, këto pajtime sa iu përket temave mund të bëhen edhe në koordinim me BE-në, sepse të dyja palët i paraqesin qëndrimet

e tyre dhe në fund Bashkimi Evropian e bën koordinimin siç e ka rolin në këtë proces", ka thënë Abrashi.

Për mundësitë e një takimi të tillë gjatë javës së ardhshme, "Ksp" ka provuar të marrë një qëndrim nga zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi dhe zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, mirëpo nuk kanë kthyer përgjigje.

Ndërsa zëdhënësi i Komisionit Evropian, Peter Stano, nuk ka bërë me dije se mund të ketë një takim paraprak të rangut më të ulët politik ndërmjet palës së Kosovës dhe asaj serbe, por thotë se datat dhe agjendën e dialogut do ta publikojnë kurdo që është e përshtatshme. "Ne do t'i shpallim datat dhe agjendën e takimeve të ardhshme të dialogut kurdo që është e përshtatshme. Si rregull i përgjithshëm, ne nuk shpallim takimet në nivelin teknik të ekspertëve. Prandaj, ne do të

bënim një njoftim vetëm nëse do të ishte i përshtatshëm", ka thënë ai.

Në takimin e parë të nivelit të lartë në kuadër të rifillimit të dialogut Kosovë - Serbi, kryeministri Kurti ka propozuar që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor të avancojnë CEFTA-n në SEFTA, Kosova dhe Serbia menjëherë nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën.

Propozimi i tretë ishte pas njohjes së ndërsjellët midis Kosovës dhe Serbisë, në të dy vendet të ketë reciprocitet bilateral, përfshirë çështjen e pakicave. Pra, serbët në Kosovë të kenë këshillin e tyre nacional siç e kanë shqiptarët dhe boshnjakët në Serbi. Ndërsa si propozim i fundit, Kurti ka kërkuar dorëheqjen e Veljko Odaloviçit nga delegacioni serb dhe ai të merret në pyetje për çështjen e të pagjeturve.



Haradinaj nuk beson se BE-ja ka aftësi ta udhëheqë dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka deklaruar se unioni ekonomik ndërmjet shteteve të rajonit, i njohur si "mini-shengeni Ballkanik", nuk mund të ekzistojë përderisa Serbia vazhdon të mos e njohë Kosovën shtet i pavarur. Ai ka thënë se Kosova është në pozitë të pabarabartë me vendet e rajonit. "Kur ndodh njohja hiqen pengesat edhe për 'mini-shengen'. Përderisa Serbia nuk na ka njohur, është një situatë e padrejtë. Kosova është në opozitë të pabarabartë në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Radha

e punëve duhet të jetë njohja e Kosovës dhe më pas 'mini-shengeni'", ka thënë Haradinaj. Ndërsa sa i përket procesit të dialogut Kosovë - Serbi, Haradinaj nuk beson se Bashkimin Evropian se është i aftë ta udhëheqë këtë proces, ngaqë brenda BE-së ka vende të cilat vazhdojnë ta refuzojnë shtetësinë e Kosovës.

Haradinaj ka kërkuar që në këtë proces të ketë një përfshirje më të madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Ne duhet ta ftojme Amerikën në tavolinë që tani në dialog, të mos ecim përpara në dialog pa Amerikën. BE-ja nuk është unike. Është

heterogjene. Kemi pesë vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Dy përfaqësuesit e lartë të BE-së që u është besuar çështja e dialogut, vijnë nga vende që nuk e njohin Kosovën. Borelli nga Spanja, Lajçaku nga Sllovakia. ShBA-ja nuk ka shprehur dilema për sovranitetin e Kosovës. Kemi interes ta kemi ShBA-në në tavolinë me ne. Bideni, që unë personalisht e njoh, është i interesuar për çështjet e Ballkanit, e njëjta çështjen shqiptare, ka qenë i familjarizuar dhe ju siguroj se është kohë ideale për ta kërkuar ndihmën e ShBA-së", ka deklaruar Haradinaj.



Kosova e harron demarkacionin me Malin e Zi



PRISHTINE, 4 KORRIK - Janë bërë tre vjet që nga ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi në Kuvendin e Kosovës dhe ende ky proces nuk mund të konsiderohet i përfunduar. Sipas kësaj marrëveshjeje të nënshkruar në vitin 2015 në Vjenë, pas ratifikimit, të dy shtetet do ta rishikojnë vijën kufitare dhe do të bëhen korrigjime nëse ka pasur lëshime.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që ishte kundërshtar i kësaj marrëveshjeje, ende nuk ka formuar komisionin shtetëror për shënjimin e kufirit.

Vitin e kaluar, më 26 gusht, sa ishte në opozitë, Kurti kishte kritikuar marrëveshjen që, sipas tij, ia ka humbur Kosovës 8.200 hektarë. "Raporti dhe puna e komisionit Bulliqi është aktakuzë për regjimin e vjetër (porsa të çlirohet Prokuroria e Shtetit) dhe orientim për korrigjim (porsa të rikthehet qeveria e mirë)", kishte shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Mirëpo, si kryeministër në mandatin e dytë, Kurti nuk ka bërë asgjë sa i përket këtij procesi. Në Qeverinë e Kosovës nuk janë përgjigjur në pyetjet e "Radios Evropa e Lirë" dhe nuk kanë treguar se kur do të formohet komisioni i ri që do të merret me çështjen e rishikimit të vijës kufitare ashtu siç e parasheh marrëveshja. Kërkesë për të formuar këtë

komision kryeministrit i ka drejtuar edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj. Në ditën e parë të punës si kryeministër në vitin 2017, Ramush Haradinaj e kishte shkarkuar komisionin e udhëhequr nga Murat Meha dhe kishte emëruar një komision të ri i përbërë nga profesorët Florim Isufi dhe Shpëtim Bulliqi.

Tash si deputet i opozitës, Haradinaj ka kërkuar më 25 qershor nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që të formojë sa më shpejt komisionin shtetëror për shënjimin e kufirit. "Është veprimi i parë që duhet të bëni në mënyrë që të mos lini vakum, që qeveria të mos ndodhet në befasi të çfarëdo natyre. Ky komision duhet të jetë funksional. Në procedurë të punës nuk kanë dalë komisioni i Kosovës dhe ai i Malit të Zi që t'i qesin gurët. Ende nuk janë vënë gurët në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Kufiri që është sot është kufiri që e kemi gjetur edhe para marrëveshjes", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, nëse Mali i Zi nuk shpreh gatishmëri të ecet në këtë drejtim, kjo çështje duhet të shkojë në arbitrazh.

Marrëveshja me Malin e Zi ishte nënshkruar sipas gjetjeve të komisionit shtetëror për shënjimin e vijës kufitare që udhëhiqej nga Murat Meha. "Nuk mund të them asgjë, sepse

çfarë kam pasur të them, e kam thënë. Çfarë kemi thënë është vërtetuar dhe me kaq e kemi përfunduar atë punë", ka thënë Meha për "Radion Evropa e Lirë".

Isufi: Gjithçka në dorë të Malit të Zi

Profesori Florim Isufi, i cili ishte pjesë e komisionit shtetëror të emëruar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj dhe i shkarkuar nga ish-kryeministri Avdullah Hoti, thotë se vetëm me vullnetin e mirë të Malit të Zi mund të ketë rishikim të kësaj vije të demarkimit. "Askush më nuk mund të bisedojë me Malin e Zi nëse duhet të bazohet në raportin e gjetjeve, sepse aty janë gjetjet që duhen përmirësuar, e pala malazeze, nëse nuk pranon, është vështirë që të përmirësohen. Vija kufitare nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të shënjohet, nëse nuk janë të dyja palët dakord. Kjo mbetet si rrugë qorre në të ardhmen derisa të krijohen komisionet", ka thënë Isufi. Ai ka thënë për "Radio Evropa e Lirë" se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duhet të takohet dhe të bisedojë me autoritetet e Malit të Zi.

Çfarë thonë banorët në zonën e kufirit?

Çdo vit Rasim Mulaj bashkë me gruan qëndrojnë nga tre muaj

në stanin e tyre në bjeshkët afër kufirit me Malin e Zi. Mulaj është nga fshati Llukë e Epërme i komunës së Deçanit, që bashkë me banorët e tjerë të kësaj ane, e kundërshtuan marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi të nënshkruar në vitin 2015. Ai ka thënë se këtyre banorëve u është bërë e padrejtë.

"Pesëmbëdhjetë fshatra na kanë lënë pa bjeshkë", ka thënë Mulaj në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë", duke shtuar se si pasojë e marrëveshjes të nënshkruar ndërmjet dy shteteve, vija kufitare tash është rreth pesë kilometra në thellësi të Kosovës. Sipas tij, Mali i Zi asnjëherë nuk e ka kontrolluar këtë pjesë dhe se Kulla e Zhlebit, ka thënë Mulaj, asnjëherë nuk ka qenë pjesë e Malit të Zi. "E kontrollojnë, kanë vendosur rrjeta në anën e epërme që të mos rrëshqasin gurët, i kanë bërë vizat e reja, e pastrojnë rrugën. Çdo gjë e kontrollojnë këta (malazezët). Pylltari është i Rozhajës, e kontrollon malin", ka thënë Mulaj.

Kur kanë kaluar tre vjet që nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje në Kuvendin e Kosovës, Kosova ka pasur katër qeveri. Asnjëra nga qeveritë nuk e ka marrë asnjë hap sa i përket rishikimit të vijës kufitare për t'i bërë korrigjimet e nevojshme nëse ka pasur ndonjë lëshim. "Unë pres prej këtyre (Qeverisë së Kosovës), sepse këta kanë qenë me këmbëngulje që të mos

votohet demarkacioni. Pres prej tyre dhe Ministrisë së Jashtme që të merren me këtë punë, të bisedojnë me Malin e Zi", ka thënë Mulaj.

Ratifikimi nën tymin e gazit lotsjellës

Nga viti 2015 deri në vitin 2018 Lëvizja Vetëvendosje si parti opozitare, por edhe partitë e tjera opozitare, e kanë kundërshtuar ashpër marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi. Kundër kësaj marrëveshjeje u organizuan protesta të shumta në sheshe dhe në sallën e Kuvendit.

Nën tymin e gazit lotsjellës, më 21 mars të vitit 2018, deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, që konsiderohej kriter për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi, e nënshkruar në vitin 2015 në Vjenë të Austrisë, është plotësuar edhe me një aneks-marrëveshje ndërmjet dy ish-presidentëve, atij të Kosovës, Hashim Thaçi dhe të Malit të Zi, Filip Vujanoviq.

Në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet dy presidentëve, thuhet se pas ratifikimit të demarkacionit në Kuvendin e Kosovës, të dyja vendet do ta rishikojnë vijën kufitare dhe do të bëhen korrigjime nëse ka pasur lëshime.

ZKA-ja identifikon mangësi në procesin e financimit të organizatave joqeveritare

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave joqeveritare". Auditimi kishte për qëllim vlerësimin nëse procesi i financimit të organizatave joqeveritare është menaxhuar si duhet, ofron transparencë të plotë, është konkurrues dhe arrin qëllimet e synuara të institucioneve publike. Subjekte të këtij auditimi kanë qenë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe komuna e Prishtinës.

Auditimi ka identifikuar mangësi në procesin e financimit të organizatave joqeveritare nga institucionet publike të audituara, të cilat rrezikojnë llogaridhënien, transparencën, konkurrancën dhe arritjen e qëllimeve të synuara. Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet publike kanë realizuar financime të projekteve të ndryshme pa thirrje publike,

pa plotësimin e kriterëve dhe vetëm me vendime të udhëheqësve, krerëve të drejtorive dhe departamenteve përkatëse. Për më tepër, organizatat joqeveritare janë përkrahur nga më shumë se një burim i financimit publik për projektin e njëjtë nga institucionet publike, ishin financiar operatorë ekonomikë të cilat nuk ishin organizata joqeveritare, si dhe kishte raste të konfliktit të interesit.

Një çështje me theks të veçantë është dështimi në vlerësimin e rezultateve për projektet e financuara si pasojë e mungesës së monitorimit të projekteve. Institucionet publike nuk kanë arritur ta monitorojnë ecurinë e projekteve dhe organizatat joqeveritare nuk janë mbajtur përgjegjëse për zbatimin e projekteve. Si rezultat, nuk ka një vlerësim nëse janë arritur qëllimet e synuara dhe nëse fushat e caktuara janë përmirësuar nga financimet e dhëna për organizatat



joqeveritare.

Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nuk ka bërë përpjekje që ta bëjë publikimin e të dhënave mbi financimet e projekteve të organizatave joqeveritare në uebfaqe dhe ta bëjë menaxhimin e bazës së të dhënave në nivel të kënaqshëm. Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk kanë pasqyruar të

dhënat e financimit përmes raporteve vjetore. Mungesa e raportimit dhe monitorimit të projekteve ka pamundësuar vlerësimin nëse janë arritur rezultatet e synuara për projektet e financuara.

Rezultatet e këtij auditimi theksojnë nevojën për përmirësimin e procesit të financimit të organizatave joqeveritare nga institucionet publike në nivelin qendror dhe

lokal.

Auditori i përgjithshëm i ZKA-së, Besnik Osmani, lidhur me këtë auditim, ka deklaruar se institucionet publike që përkrahin organizatat joqeveritare kanë një rol të rëndësishëm që përmes një financimi të duhur dhe transparent të OJQ-ve ta përmirësojnë jetën qytetarëve në fusha të ndryshme ekonomike-sociale. Megjithatë, mangësitë e identifikuar në auditim paraqesin një shqetësim për menaxhimin e procesit të financimit të organizatave joqeveritare dhe transparencën nga institucionet publike.

Me qëllim të adresimit të shpejtë të çështjeve rreth menaxhimit të procesit të financimit të organizatave joqeveritare si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë nëntë rekomandime për zyrën e kryeministrit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe për Komunën e Prishtinës.

Bashkatdhetarët këtë vit kanë dërguar më shumë para në Kosovë, priten të hyra deri në 1 miliard euro

PRISHTINË, 4 KORRIK - Dërgesat nga bashkatdhetarët sivjet kanë shënuar një trend rritës dhe pritet që deri në fund të vitit të arrijnë mbi njëmiliard euro. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në tremujorin e parë të këtij viti remitencat kanë arritur shumën 250 milionë euro ose rreth 60 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pavarësisht prej krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia Covid-19, remitencat më 2020 kanë shënuar rritje 120 milionë më shumë se në vitin 2019.

Profesori universitar i ekonomisë, Muhamet Sadiku, ka deklaruar se lidhja e bashkatdhetarëve me Kosovën ka qenë gjithnjë e fuqishme dhe ka vazhduar një trend i dërgesave të mëdha të cilat janë gati sa gjysma e buxhetit të Kosovës, respektivisht rreth 13 për qind e Bruto Produktit Vendor. "Edhe përkundër problemeve që ka sjellë pandemia, lidhja e



diasporës me Kosovën ka qenë gjithnjë e fuqishme dhe ka vazhduar një trend i dërgesave të mëdha të cilat janë rreth 40 për qind e buxhetit të Kosovës, respektivisht rreth 13 për qind e Bruto Produktit në vend. Remitencat janë treguar burim i

sigurt dhe afatgjatë i zhvillimit ekonomik të Kosovës, pavarësisht se 90 për qind e remitencave shkojnë në mbulimin e konsumit familjar në Kosovë. Kjo është një strukturë e ndërtuar nga niveli i lartë i papunësisë dhe niveli i lartë i varfërisë. Paratë e diasporës në

një përqindje të vogël orientohen në investime për hapjen e vendeve të punës", ka thënë Sadiku. Ai ka treguar se një pjesë e madhe e këtyre parave shkojnë në mbulimin e importit të madh, pasi Kosova i ka 2,4 miliardë euro në vit import.

Sipas studimeve të ndryshme, për orientimin e remitencave në investime, Kosova duhet të ndërtojë një mjedis biznesor të favorshëm për investitorë të huajë e nga diaspora. Ndërsa zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Kushtrim Ahmeti, ka thënë, në një përgjigje me shkrim për "Kosovapress", se përgjatë muajve janar-mars remitencat kanë arritur 243 milionë euro.

"Vlera totale e remitencave për tremujorin e parë të këtij viti (janar-mars 2021) ishte 242.9 milionë euro, që është më e lartë për 55.6 milionë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar, ku vlera e remitencave ishte 187.3 milionë euro", ka thënë Ahmeti.

Kujtojmë se në mbledhjen e fundit të ekzekutivit të udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti është marrë vendim që të mbulohen shpenzimet e policës kufitare në vlerë deri 6 milionë euro për bashkatdhetarët.

Ministri Peci thotë se do të kompensohen fermerët e dëmtuar nga breshëri

MITROVICË, 4 KORRIK (ER) - Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHr), Faton Peci, ka vizituar të dielën fshatrat Vidimriq, Çabër dhe Kushtovë në komunën e Mitrovicës dhe Zubin Potokut. Së bashku me drejtorin e Bujqësisë në

komunën e Mitrovicës, Ekrem Sadiku, ministri Faton Peci, ka vizituar disa fermerë të kësaj zone të cilët kanë pësuar dëme të konsiderueshme nga reshjet e fundit të breshrit.

Gjatë kësaj vizite Peci ka njoftuar fermerët dhe kultivuesit e kësaj zone se

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të politikave të qëndrueshme edhe në ndërmarrjen e masave preventive nga dëme të tilla. "Duke u nisur nga kjo, MBPZHr-ja po angazhohet që në një të ardhme të afërt të mundësohet që sigurimet



bujqësore ta përfshijnë shumicën e kulturave bujqësore", ka thënë ai. Po ashtu, Peci i ka njoftuar të pranishmit se ka proceduar në mbledhjen e radhës së qeverisë si pikë të rendit të ditës kompensimin e dëmeve për kulturat bujqësore në vlerë prej 1.3 milion eurosh.





RRËFIME NGA I BURGOSURI E I MBIJETUARI I MASAKRËS NË BURGUN E DUBRAVËS, NAIT HASANI

Burgu i Nishit dhe telefonata nga Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Kadri Veseli, 'Plaku' dhe Adem Demaçi



Sa herë vinte nata, pasi hanim darkë, mbyllej dera e hekurt. Të burgosurit i nxirrnin telefonat të cilët i kishin fshehur nëpër biruca të dhomave, nën dysheme e në antenat e TV-së. Këto telefonata sa i dispononin aq dhe i nervozonin të burgosurit nga lajmet që i merrnin nga familjarët e tyre. Ditën lexonim libra të ndryshme, në gjuhën shqipe dhe serbe. Edhe ndonjë gazetë që vinte nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut në Preshevë. Dëlnim për shëtitje për ajër të pastër dhe ndonjëherë luanim me top. Në katin tonë

kishte vetëm shqiptarë nga Kosova dhe nga Lugina e Preshevës që ishin arrestuar për shkak të pjesëmarrjes në UÇPMB. Pasi kalonim kohën e programuar sipas rregullores, hynim brenda në katin tonë, nëpër dhoma dhe te salla e TV-së, duke shikuar mos ka ndonjë lajm të ri për gjendjen në Kosovë apo në rajon. Pasi ishte nënshkruar Marrëveshja e Ohrit, shtypi serb e komentonte me ton kërcënimi dhe humbje të Maqedonisë dhe nxiste ndarje me qëllim për ta mbajtur gjallë konfliktin në mes të shqiptarëve,

duke përsëritur se kjo marrëveshje është e dëmshme dhe kundër stabilitetit të Ballkanit. Në fakt, kjo marrëveshje ishte një hap i fillimit të mbarë të zgjidhjes së çështjes shqiptare në Maqedoni dhe krijimit të barazisë së popujve si dhe të drejtën që shqiptaret të jenë shtetndërtues në Maqedoni, që deri atëherë kishin qenë të shtypur, njëkohësisht ishin qytetarë të rendit të dytë e të tretë në Maqedoni. Ne me Naimin dhe Isakun e komentonim këtë gjendje, rezultatet si dhe dobitë e

të arriturave me luftë të shqiptarëve në këto rrethana politike. Pas darkës, kur mbyllej dera e hekurt, telefonat cingëronin sa te njëri sa te tjetri. Disa kujdeseshin në korridor për të parë mos vinte ndonjë gardian, edhe pse në shumicën e rasteve gardianët i kishin sjellë vetë telefonat në këmbim të një shpërblimi nga të burgosurit. Megjithatë, nëse zbulohesh ndonjë telefon te ndonjëri nga të burgosurit, ai shkonte në vuajtje në "shtëpinë e bardhë". Atje trajtohej me të mirat

e mundshme të specialitetit human të gardianëve të pakorruptuar! Për këtë arsye, nën kujdes të rreptë nga të burgosurit bëheshin biseda me familjet në Kosovë. Gjatë kësaj kohe pata disa biseda telefonike. Përveç Rexhep Selimit, me të cilën bisedën e patëm për gjendjen në Kosovë, përfundimin e luftës dhe rënien e shokëve të Mujë Krasniqit komandant 'Kapuçit', Myrtë Zenelit, nënës Azë Brahimaj, të Adem Jasharit e të tjerëve shokë e bashkëluftëtarë, kemi biseduar edhe për botimin e

librit tim me poezi "Ende jam gjallë".

Një ditë në telefon më merr Hashim Thaçi, bashkëluftëtari im dhe më pyet për shëndetin dhe gjendjen time në burg. Më tregon për gjendjen në Kosovë dhe për përpjekjet që po bëjnë për lirim tonë. E falënderoj dhe i them se nuk dyshoj që ju po bëni punë për të na liruar, por kjo varet nga rrethanat dhe kushtëzimet që mund t'ia bëni faktorit ndërkombëtar e ai Serbisë. Uroj që kanë përfunduar me suksese proceset historike, çlirimi i Kosovës nga Serbia dhe duhet të keni kujdes se si thotë një fjalë popullore "uji fle e hasmi (Serbia) nuk fle". Thaçi më njoftoi se bëheshin përgatitjet për zgjedhjet e para lokale të pas luftës. Më tregon se po organizohen si subjekt i ri politik për zgjedhje. Shpresojmë në vullnetin e qytetareve që të fitojmë. Uroj të fitoni! Por, si do që të jetë, Kosova është çliruar tashmë, dhe kushdo që të fitojë, të punoj për Kosovën, i thashë unë.

Pas disa ditësh flas edhe me bashkëluftëtarin tjetër, Kadri Veselin. Edhe me Kadriun bashkëbiseduam për situatën politike dhe i tregova se çfarë po shkruan shtypi serb dhe çfarë lufte po bën për të nxitur konflikte në Kosovë. Kadri Veseli më thotë ruaje shëndetin, se me Serbinë e kemi kryer luftën. Në Kosovë mirë është situata, të dëbuarit janë duke u kthyer nëpër shtëpi. Janë duke u rindërtuar me të madhe shtëpitë e djegura. Ka shumë viktima të cilat po i kërkojnë familjarët e tyre. Po i mashtrojnë disa avokatë serbë se i kanë parë ose janë këtu e aty familjarët e tyre, me qëllim që të përfitojnë sa më shumë lekë nga familjarët, por edhe t'i rritin sa më shumë vuajtjet shpirtërore të ta me premtime boshe. Me këso premtime këta, i thashë, duan t'i shkatërrojnë psikikisht familjet e tyre. Më pyeti a di gjë për Ukshin Hotin. I thashë se deri kur ka dalë nga burgun në Dubravë, kur u përshëndet me ne për herë të fundit, pra derisa ka dalë nga rrethoja e burgut, e dimë, më shumë askush nuk di. Të gjitha të tjerat, i thashë, janë fjalë. Në evidencat e Kryqit të Kuq nuk është i marrë peng. Gjatë kësaj kohe më ka thirrur "Plaku" disa herë dhe më fliste me emocion dhe tregonte për gjendjen në Drenicë dhe Prishtinë, për Policinë e Kosovës e cila sapo ishte krijuar. Edhe ai ishte diku në polici në një departament të punës. Më tregonte për përpjekjet që po bën për familjet e dëshmorëve dhe fëmijët e tyre për t'i dërguar nëpër shkollë.

Më kanë thirrur edhe shokët që kemi qenë në burgje si Xhavit Bajraktari nga Mitrovica, vëllai nga Gjermania, familja, Fatmirja e shumë të tjerë. Të gjithë interesoheshin për shëndetin dhe kushtet e burgut. Tashmë burgu ishte më i lehtë. I lehtë sepse nuk kishte dhunë të drejtpërdrejtë si para rënies së Millosheviqit.

Tashmë kishte dhunë psikike dhe torturë. Por, sa më shumë zgjateshin ditët në burg, aq më shumë te të burgosurit bëhej e padurueshme kjo gjendje dhe kjo kuptohej nga britmat e nervozizmi i tyre që dukej në sjellje, duke pirë duhan një pas një dhe kjo dukej në pamjen e tyre - fytyrë.

Ardhja e Albin Kurtit në burgun e Nishit

Në rutinën e përditshme, një pasdite erdhi një i burgosur i ri. Disa kishin marrë vesh më herët që ka mbërritur ai i burgosur dhe poshtë janë duke ia marrë të dhënat dhe tash po e sjellin në katin tonë. Një nga të burgosurit tha se është Albin Kurti. Të gjithë e pritnin se kur ngjitet shkallëve, ndërsa ne në dhomë bisedonim e diskutonim për çështje të ndryshme. U hap dera dhe hyri Albini. Gardiani tha këtu është një vend për mysafirin e ri dhe ai doli. Ne u përshëndetëm me të, u



përshëndet edhe me të tjerët në dhomë dhe filluam të bisedojmë për gjendjen tonë nëpër burgje, për shëndetin, për familjet, për situatën në burg dhe situatën në Kosovë. Në biseda e sipër erdhi darka. Hëngrëm darkë dhe përsëri filluam të bisedojmë për rrethanat politike. Albini i mori gjërat e veta që i kishte me vete dhe nxori disa libra filozofikë në shqip dhe anglisht. Vinin ta përshëndesnin herë një e herë një tjetër në dhomë. Dikush pyeste ndonjë gjë dhe përpiquej ta shpjegonte situatën. Disa mermin vesh, disa të tjerë bënin se kuptonin e kështu ecte nata.

Në mëngjes, sapo u zgjuam sipas orarit, dikush në dhomë tregonte ndonjë ëndërr që kishte parë, dikush fliste me nervoz, dikush ashtu e kështu, që e bënin dhe mëngjesin të zymtë, por dhe qesharak. Në mëngjes bëmë pastrimet, morëm mëngjesin dhe më pas prapë filluam të debatoni për situatën politike në Kosovë, në rajon të shqiptarëve dhe për mbështetjen e miqve

ndërkombëtarë. Diskutoni për ata që na kishin mbështetur në histori dhe për ata që na kishin ndarë në të kaluarën. Në këto debate përmendeshin edhe dijetarë të ndryshëm që kanë studiuar rryma të ndryshme të filozofisë politike. Nga demokracia liberale deri te sistemet kapitaliste dhe socialiste. Edhe për Fromim që ka studiuar procesin e turmave dhe njerëzve që hiqnin dorë nga liria e vet dhe e bartnin lirinë te udhëheqësi i tij që ai bënte përfaqësimin e plotë të turmës, ku filozofë të ndryshëm kishin analizuar që nga Musolini e deri te Hitleri dhe turmat e sistemeve komuniste.

Ne debatoni në konteste të tilla për t'u kuptuar konceptet politike të liderëve e udhëheqësve të ndryshëm botërorë dhe të tanëve. Filozofia politike e drejtuesve tanë ishte filozofi e tërheqjes në vete, e mbylljes pa koncept e shprehur në një frazë me dëshira absolute, por pa veprim praktik.

Diskutoni për luftën, për

nacionalistë e separatistë me dënime të rënda. Sipas statistikave, në vitet tetëdhjetë rreth 700 mijë shqiptarë kishin kaluar nëpër duart e policisë sekrete në Kosovë, që i binte se çdo i dyti ka qenë pjesë e trajtimit të policisë dhe të dënuar mijëra të tillë nga këta gjykatës e policë. Këto tregonin se liria u fitua dhe çlirimi u arrit nga Serbia, megjithatë një të kaluar të brishtë të disave që janë futur në sistemin e drejtësisë dhe policisë, neve si popull tashmë na duhet një pajtim kombëtar për zhvillimin e vendit dhe drejtësia të merret me krijimin e kushteve për një jetë më të mirë.

Deklaratat që jepnin drejtues ndërkombëtarë dhe pikat e Hakerupit që i komentoni. Në këto pika shihej që një gjë e mirë nuk pritej si liri kombëtare, por si koncept qytetar, në një territor të caktuar. Diku pajtoheshim dhe nuk pajtoheshim në mes vete edhe me Albinin, por ne debatoni me diskutoni mbi ato


të rinisë dhe kështu na iku koha e pauzës, më pastaj u kthyem nëpër dhomat tona.

Pasdite filluam t'i lexonim librat aty ku kishim mbetur. Unë lexoja Fromin, "Ikje nga liria". Analizoja konceptet e tij mbi lirinë, tjetërsimin e lirisë, sistemet totalitare, udhëheqësit totalitarë në diktatura e demokraci, abuzimet me lirinë etj. Tjetërsimi i lirisë është kur turmat kanë dëshira, por ato nuk mund t'i realizojnë dhe mendojnë se udhëheqësi do t'i mbrojë e realizojë këto dëshira. Duke parë këtë, kuptojmë se turma e krijuar bëhet një me udhëheqësin dhe krijojnë diktaturat më të tmerrshme që bartë udhëheqësi në interes të egove të tij personale, duke shtypur lirinë në emër të lirisë. Këso turma kishim edhe në Serbi me Millosheviqin, kur popullata e tërë serbe hoqi dorë nga liria e vet dhe e barti lirinë te kryetari i tyre. Këto turma amorfe pastaj u bënë turma të rrezikshme që krijuan diktaturën e Millosheviqit dhe luftërat në Jugosllavi, duke shkatërruar si në mesjetë çdo gjë të huaj që nuk ishte e tyre, ose duke përvetësuar dhe bërë të vetën çdo gjë për të krijuar identitet politik. Në ballafaqime me këso situatë kuptohej më lehtë edhe mendimi filozofik, duke parë vrazhdësinë e turmave edhe në burgje dhe egërsinë e gardianëve duke përdorur dhunën kundër atyre që nuk mendonin njëjtë, pra neve si shqiptarë që kërkonim liri e çlirim.

U dëgjuan dyert e hekurit e britmat e gardianit si dhe krisma e pjatave që mbanin të burgosurit duke marrë ushqimin e darkës. Morëm darkën dhe, duke hëngër darkë, bisedonim për ato që i kishim lexuar. Pas darkës, sapo u mbyllën dyert e hekurit dhe shkuan gardianët, të burgosurit nxorën telefonat nga vendet që i kishin fshehur. Ia filluan të bisedonin si në postë. Secili në këndet e qoshtet që i nxinte. Në një çast na thërrasin në tel dhe na sjellin neve që të flasim. Tashmë në Prishtinë e Kosovë e dinin se unë dhe Albini ishim bashkë në burgun e Nishit. Atje kishin bërë edhe protesta dhe angazhime të ndryshme për lirim tonë. Kur na sollën telefonin, dëgjohej një zë i njohur. Ishte baca Adem. Adem Demaçi. E kërkoj Albinin dhe për disa minuta folën bashkë, pastaj fola edhe unë me bacën Adem për disa minuta. Me bacën Adem, përveç përshëndetjeve, diskutuam edhe për gjendjen dhe faktorin ndërkombëtar në Kosovë. Po ashtu, folëm për kushtet e burgut dhe për shëndetin. Folëm për qëndrimin në burg, duke na dhënë këshilla për burgun dhe shfrytëzimin e kohës në burg për t'u përgatitur profesionalisht me dije. Na tha lexoni libra më shumë dhe mos humbni kohën kot. Këto ishin këshilla të mira të bacës Adem, sepse ai kishte një përvojë të gjatë nëpër burgje. Ai ishte simboli im!

(Vijon)

gjëra që kishim informacion apo që kishim mundur të merrnim informata. Të tjerët aty dëgjonin apo ndonjëri bashkëngjitej në bisedë, por në diskutim merrnin pjesë edhe Naimi, Isaku, Vehbiu, sepse bisedonim secili në mënyrën tonë, pasi secili e donim vendin tonë deri në flim, sepse këtë e dëshmonte dashuria për atdheun dhe lufta e qëndresa jonë ndaj dhunës që përdorej ndaj nesh. Gjatë diskutimeve në korridor thërret gardiani për të dalë në shëtitje. U bëmë gati dhe dolëm. Morëm një top të basketbollit e një të futbollit, sepse në oborr ishte një fushë dhe kishim mundësi për të luajtur. Ne të burgosurit më herët luanim më shumë futboll gjatë orës së shëtitjes që e kishim, ndërsa të tjerët shëtitnin e bisedonin nëpër oborr rreth fushës. Pasi erdhi Albini ai e pëlqeu më shumë basketbollin dhe ne morëm topin e basketbollit dhe filluam të luanim së bashku. Luanim aq sa dinin, bënim humor dhe biseda



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Haxhijaj: 100 mijë euro shpërblim për medaljen olimpike



PRISHTINË, 4 KORRIK - Lojërat Olimpikë janë padyshim një nga ngjarjet më të mëdha sportive në botë. Kosova është përfaqësuar denjësisht nga sportistët e saj në këtë ngjarje vitet e kaluara dhe ka për synim që të njëjtën gjë ta bëjë edhe kësaj radhe në Tokio. Tashmë janë duke u bërë përgatitjet finale dhe ekipi prej 11-sportistësh nga fusha të ndryshme është i gatshëm ta përfaqësojë Kosovën përkrah 200 vendeve të tjera që marrin pjesë në këtë ngjarje. Pjesëmarrja në një eveniment kaq të madh dhe të rëndësishëm për sportin natyrisht se ka edhe një kosto të madhe, por sekretari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Shasivar Haxhijaj, për "KosovaPress" zbulon se nuk do të mungojnë edhe shpërblimet për ata

sportistë të cilët arrijnë rezultate të mira ose fitojnë medalje në Tokio. Në rast se një sportist arrin ta fitojë medaljen e artë atje, shpërblimi që e pret në Kosovë është 100 mijë euro. "Çdo kund në botë shpenzimet për të arritur një medalje olimpikë janë jashtëzakonisht të mëdha, ndoshta Kosova bën shpenzime më së paku në të gjithë rruzullin tokësor. Arsyet janë të shumta sepse edhe kushtet tona si Kosovë nuk janë të nivelit shumë të lartë ashtu siç do të dëshironim ne si komunitet i sportit që sportistët tanë t'i kenë kushtet më të mira. Mirëpo me kapacitetet që i ka Kosova, realisht institucionet e Kosovës kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e këtyre sportistëve

që ata ta arrijnë nivelin më të mirë të mundshëm dhe normal. Këto përgatitje duan edhe kosto, duan edhe shpenzime. Ta zëmë, një medalje olimpikë nëse e fiton, një medalje të artë olimpikë, shteti i Kosovës i jep 100 mijë euro neto për atë sportist dhe gjysmën e saj për trajnerin. Kjo ka ndodhur edhe kur Majlinda Kelmendi e ka fituar medaljen e artë në Rio. Krahas kësaj janë edhe shpërblimet për medaljet e fituara në Kampionatin Botëror dhe Kampionatin Evropian. Të gjitha këto prej institucioneve respektohen, po ashtu edhe infrastruktura është e kushtueshme", ka deklaruar Haxhijaj. Ndryshe, Lojërat Olimpikë Tokio 2020 do të zhvillohen nga 23 korriku deri më 8 gusht 2021.

"EURO 2020"

Shaqiri në formacionin e çerekfinaleve të 'Euro 2020'

UEFA ka publikuar emrat e futbollistëve më të mirë në fazën çerekfinale të Evropianit teksa shihet qartë një dominim i "Tre Luanëve" në formacion. Në portë më i miri u shpall Sommer i Zvicrës i cili bëri 10 pritje në sfidën ndaj Spanjës. Në mbrojtje rreshtohen Coufal (Çeki), Maguire (Angli), Vermaalen (Belgjikë) dhe Shaw (Angli). Në mesfushë, në qendër, rreshtohet Delaney (Danimarkë) dhe Shaqiri (Zvicër), ndërsa nga krahët Sancho (Angli) dhe Insigne (Itali). Sulmi ndahet mes Keane (Angli) i cili është më i titulluari me notën 9.3 dhe Dolberg (Danimarkë).

Shevchenko: Episodet vendosën për ndeshjen

Ukraina luajti për herë të parë në histori një ndeshje çerekfinale në Evropian. Djemtë e Andriy Shevchenkos zhvilluan një pjesë të parë pozitive, por në fund u mposhtën 4-0 nga Anglia, që siguroi kalimin në katër ekipet më të mira të "Euro 2020". "Ndeshja u vendos nga episodet. Anglia është shumë më e fortë se ne, por episodet ndikuan. Ne humbëm qendërmbrojtësin që mund t'u shkaktonte probleme atyre (Kryvtsov). E vërtetë që ndodhi një rënie përqendrimi në goditjet standarde, e paguam shtrenjtë një gjë të tillë. Ukraina ka zhvilluar një Evropian të shkëlqyer, pavarësisht prej vështirësive dhe mungesave, kemi zhvilluar një futboll të bukur", ka deklaruar Shevchenko.

Southgate: Një gjysmëfinale në 'Wembley' është përrallore për vendin tonë

Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, është shfaqur i lumtur për rezultatin edhe ecurinë e kombëtares së "Tre Luanëve", ndërkohë që tregon se halli i tij më i madh është lënia jashtë e lojtarëve. Anglia e mposhti Ukrainën me rezultat 4-0. "Lojtarët kanë qenë fantastikë. Mendoj se djemtë që futen në fushë si zëvendësues e bëjnë këtë ekip të suksesshëm. Shpirti i grupit është fenomenal. Kushdo që hyn bën punën, por edhe ata që nuk futen. Po shpenzoj më shumë energji për të vendosur për tre lojtarët që mbeten jashtë, pasi të gjithë janë lojtarë të mirë. Asnjë prej tyre nuk e meriton të lihet në tribunë. Është përrallore. Kemi arritur një tjetër gjysmëfinale. Duam të shkojmë dy hapa më tej. E di se çfarë do të ndodhë në shtëpi. Është përrallore për vendin tonë, një gjysmëfinale në 'Wembley'. Të gjithë mezi e presin këtë. Është brilante", ka shtuar Southgate.

Trajneri i Danimarkës, pas kalimit në gjysmëfinale: Është diçka magjike

Trajneri i Danimarkës, Kasper Hjulmand, ndihet i lumtur pas fitores ndaj Republikës Çeke (2-1) dhe kalimit në gjysmëfinale të "Euro 2020". Fitorja e

danezëve erdhi falë golave nga Thomas Delaney dhe Kasper Dolberg, ndërsa për çekët golin e vetëm e shënoi Patrick Schick. "Nuk ishte bukur, por pati një luftë dhe

një portier fantastik. Bateritë ishin pothuajse bosh, por është diçka e madhe për ta arritur gjysmëfinalen në 'Euro 2020', ka thënë Hjulmand. "Është magjike.

Gjëja e parë që u tregova djemve kur u takuam ishte një fotografi e 'Wembleyt' nga kur ishim atje në vjeshtë. U thashë që do të ktheheshim. Ndihej si kemi

luajtur përsëri në një stadium danez për shkak të mbështetjes së tifozëve tanë. Ne jemi shumë mirënjohës", ka thënë trajneri i Danimarkës.

Messi: Duam Kupën e Amerikës

BUENOS AIRES, 4 KORRIK - Argjentina fitoi 3-0 ndaj Ekuadorit. Triumfi i pastër i kombëtares albiceleste, që do të përballë me Kolumbinë në duelin gjysmëfinale të Kupës së

Amerikës (Brazil-Peru gjysmëfinalja tjetër). Për mediat foli Leo Messi, autor i dy asistimeve dhe një goli nga goditja e dënimit. 76 gola me kombëtaren për kapitenin, i cili

është 1 gol larg rekordit të mbretit Pele (77 gola). "Mbërritja në gjysmëfinale ishte objektivi primar. Rekordi i Peles? Objektivat personale janë sekondare. Ndodhemi këtu për

një tjetër gjë. Duam ta fitojmë Kupën. Do të luftojmë fort deri në fund për t'ia dalë. Kolumbia ka lojtarë ekspertë dhe shumë të shpejtë, por ne duam të dalim në finale", ka thënë Messi.



Berisha: Mezi pres ta filloj aventurën e re në Torino

TORINO, 4 KORRIK - Pas një sezoni në Serinë B me Spalin, Etrit Berisha rikthehet sërish në elitën e futbollit italian, këtë herë për ta veshur fanellën e Torinos, me të cilën firmosi një kontratë të vlefshme për tre sezonet e ardhshëm. Gardiani i Kombëtares Shqiptare kaloi me sukses vizitat mjekësore dhe firmosi me klubin "granata" ku do të marrë vendin e italianit Sirigu dhe do të duelojë për postin e titullarit me serbin Milinković-Savić. Menjëherë pas firmës mbi kontratë, Berisha reagoi në rrjetet sociale, ku falënderoi klubin dhe tifozët e Spalit për dy sezonet e kaluara në Ferrara dhe u shpreh se me Torinon nis një etapë e re e karrierës së tij.

"Ferrara! Ishte vërtet kënaqësi të isha pjesë e juaja gjatë këtyre dy sezoneve të kaluara së bashku, ku



mësova shumë dhe dhashë gjithçka. Në këtë qytet më keni bërë të ndihem si në shtëpi... Tani rifillim udhëtimi im në një ekip të ri dhe mezi pres që ta nis punën", ka shkruar Berisha. Gardiani 32-vjeçar nga Prishtina

u transferua në Serinë A në verën e 2013-s te Lazio, ku qëndroi për tre sezone, ndërsa po tre vjet mbajti veshur edhe fanellën e Atalantës, para se të transferohej te Spali, ku luajti një sezon në elitë dhe një tjetër në Serinë B.

Milwaukee mposhti Atlantën dhe rikthehet në finale pas 47 vjetësh

MILWAUKEE, 4 KORRIK - Milwaukee Bucks rikthehet në finalen e NBA-s pas 47 vjetësh. Skuadra nga Wisconsin mposhti Atlanta Hawksin në ndeshjen e 6-të të finales së konferencës së Lindjes me rezultatin 118-107, duke e mbyllur serinë me shifrat e përgjithshme 4-2 me ndeshje dhe duke marrë në duar trofeun e kampionit të konferencës por, mbi të gjitha, duke siguruar finalen e mëdha ku përballë do të ketë Phoenix Sunsin. Një arritje madhështore për Bucksin që ia doli të thyejë dy herë radhazi Hawksin pa ndihmën e superyllit të tyre Giannis Antetokounmpo, i cili vijon të jetë i lënduar dhe rolin e liderit e mori përsipër Khris Middleton që shënoi 32 pikë. Një paraqitje të jashtëzakonshme dhuroi edhe një tjetër prej basketbollistëve më të mirë të Milwaukee, Jrue Holiday, i cili realizoi 27 pikë, kapi 9 topa në



tabelë dhe dhuroi 9 asistime, shumë pranë një "triple-double", ndërkohë që ylli i Atlantës, Trae Young, i rikthyer pas dëmtimit, e mbylli me vetëm 14 pikë. Sfidat e zhvilluar në "State Farm Arena" të Milwaukee nisi mirë për Bucksin që kapi edhe një diferencë dyshifrore, por skuadra nga Georgia u rikthye në lojë duke e

ngushtuar rezultatin, aq sa dy pjesët e para u mbyllën me vetëm 4 pikë epërsi për vendasit. Në fraksionin e tretë shpërtheu "mbreti Mida", Khris Middleton, që nisi të realizonte në mënyrë të vazhdueshme duke qenë i pakontrollueshëm për Hawksin, aq sa në mbyllje të segmentit ekipi i Budenholzerit kishte një avantazh prej 19 pikësh, 91-72, raporton "Supersport". Atlanta nuk u dorëzua dhe në fraksionin e fundit e ngushtoi diferencën deri në -6, por më pas nuk pati më forcë dhe "hodhi armët" përballë Milwaukee. Një fitore mjaft e rëndësishme e ardhur pa ndihmën e një basketbollisti të klasës së lartë si Antetokounmpo, dëshmon forcën e grupit që Bucks ka dhe tashmë e pret finalja e madhe e NBA-së për ta kërkuar titullin e parë kampion pas 50 vjetësh "agjërimit", me shpresën që Giannisi të rikthehet në parket.

SHKURT

Tetova, trajner i Ulpianës

Skuadra e Ulpianës ka paraqitur trajnerin e ri. Në stolin e "Qytetarëve" do të ulet Edlir Tetova. Ish-ndihëstrajneri i Tiranës ka firmosur kontratë njëvjeçare deri në vitin 2022. Lajmin e ka bërë me dije klubi në konferencë për media. "Kur keni një skuadër me cilësi dhe talent, ne do të përpiqemi t'i bëjmë tifozët krenarë. Është kënaqësi dhe nder i jashtëzakonshëm të jem këtu", ishin fjalët e para të tij.

Kroos: Do të pensionohem te Real

Toni Kroos po planifikon ta përfundojë karrierën në Real Madrid. Ai, gjithashtu, mund të nënshkruajë një zgjatje të kontratës kur marrëveshja e tij aktuale të përfundojë më 2023. Pasi i dha fund karrierës së tij ndërkombëtare 11-vjeçare me Gjermaninë, Kroosi tani është plotësisht i përqendruar ta luajë pjesën tjetër të karrierës së tij në "Estadio Santiago Bernabeu". "Unë besoj se viti 2023 është i përshtatshëm. Unë do të jem 33", ka thënë Kroos në një intervistë për "Bild". "Unë do të vendos nëse do të rinovoj në Real Madrid për një sezon ose dy, që është ende e hapur për diskutim, por unë jam absolutisht i sigurt që do të pensionohem në Real Madrid", ka shtuar Kroos.

Ronaldo pritet të qëndrojë në Juventus

Duket se Cristiano Ronaldo ka vendosur përfundimisht t'ia përkushtojë të ardhmen Juventusit, pasi menaxheri i tij Jorge Mendes u ka kërkuar bardhezinjve zgjatjen e kontratës së portugezit edhe për një vjet. Ish-ylli i Manchester Unitedit dhe Real Madridit e ka vetëm edhe një vit në kontratën e tanishme me Juventusin dhe, sipas mediave italiane, ai dëshiron të qëndrojë në Torino për edhe një sezon tjetër. Sipas "Gazzetta dello Sport", bisedimet mes palëve nuk kanë nisur ende, por Juventusit është njoftuar me dëshirë e Ronaldos për ta vazhduar marrëveshjen deri në verën e vitit 2023. Juventusit është i vetëdijshëm se Mendesi ia ofroi Ronaldon PSG-së dhe Manchester Unitedit në fund të sezonit, por asnjëri prej këtyre dy klubeve nuk shfaqti interesim për 36-vjeçarin. Juventusit ka kërkuar kohë për ta marrë vendimin, duke qenë se Ronaldo është lojtari më i paguar në klub me pagë vjetore prej 31 milionë eurove. Megjithatë ai i shënoi 100 gola gjatë tre vjetëve në Torino, pandemia e koronavirusit e ka bërë të vështirë për bardhezinjtë që ta mbajnë portugezin edhe më gjatë me një pagë aq të lartë.

Barça ia ofron Juves Pjaniçin me parametra zero

Sipas asaj që shkruan "Mundo Deportivo", Barcelona është fokusuar të rinovimi i Lionel Messit dhe për këtë i duhen të ardhura. Blaugranasit i kanë ofruar falas Juventusit kartonin e mesfushorit Miralem Pjaniç i cili u transferua sezonin e kaluar po nga bardhezinjtë. Pjaniç i kushtoi Barcelonës një shumë prej 60 milionë eurosh përfshirë këtu edhe kartonin e mesfushorit Arthur i cili u bashkua me torinezët. Katalanasit nuk kërkojnë të privohen nga rroga e lartë e Pjaniçit dhe ia kanë ofruar futbollistin Juves pa asnjë kosto. Pjaniç nuk arriti të lërë gjurmë te Barcelona pasi trajneri Kuman nuk e ka parë të udhës të mbështetej te aftësitë e mesfushorit boshnjak i cili u transferua me shumë bujë në "Camp Nou".

Rrëfëhet gruaja që shkaktoi aksidentin në Tur: Kam frikë për jetën time

Vazhdon të qëndrojë në paraburgim gruaja që shkaktoi aksidentin masiv në etapën e parë të Turit të Francës, ku dhjetëra çiklistë u rrezuan në rrugë. Disa prej tyre pësuan dëmtime dhe disa të tjerë u

tërhoqën nga turneu. Shkak u bë një 30-vjeçare franceze, që mbante një pankartë, e cila pengoi çiklistët, që më pas u rrezuan njëri pas tjetrit në një rrugë të ngushtë. Policia, që vijon hetimet, e ka shtyrë edhe

për 24 orë masën e arrestit ndaj gruas. "Bëra një gabim dhe më vjen turp për atë dëm të madh që kam shkaktuar", mësohet se ka thënë gruaja që jeton në Finistere, identiteti i së cilës nuk bëhet me dije. Mësohet,

githashtu, se ajo u ka thënë hetuesve se ka frikë për jetën e saj pas këtij veprimi të papërgjegjshëm që ka kryer. Hetuesit sqarojnë se personaliteti i gruas është "lehtësisht i thyeshëm" dhe se

duhet ruajtur qetësia, për të mos rënduar gjendjen e saj psikologjike. Pritet që ajo të dënohet me 1 500 euro gjobë, ndërkohë që shumica e çiklistëve nuk e kanë denoncuar.



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfën", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.


5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi


Njoftim për mbrojtje publike të Punimit të Doktoratës

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 13.07.2021, (e martë), prej orës 11:00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidatja Msc. Arta Jashari Goga i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me temën: "Ndikimi i praktikave të menaxhimit të resurseve njerëzore në qëndrueshmërinë e biznesit", me mentor Prof. Dr. Enver Kutllovci, para komisionit profesional, në përbërje prej:

Prof. Asoc. Dr. Besnik Krasniqi- kryetar i komisionit,

Prof. Asoc. Dr. Ymer Havolli- anëtarë i komisionit,

Prof. Asoc. Dr. Selajdin Abdul- anëtarë i jashtëm i komisionit (Universiteti i Evropës Juglindore- Tetovë)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lejla Mavriqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

